



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 15.1 (j), 21.2, 23.1 dhe 50 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, me datë 4 qershor 2008), dhe në përputhje me Nenin 37.5 të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës, datë 17 janar 2011,

Me qëllim të përcaktimit të autorizimeve të inspektorëve të AAC-së gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive zyrtare,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 08/2011
PËR AUTORIZIMET DHE KREDENCIALET E INSPEKTORËVE

Neni 1
Fushëveprimi

Kjo Rregullore i përshkruan autorizimet e inspektorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të autorizuara duke përfshirë përmbajtjen dhe formën e kartelës së kredencialeve të inspektorit.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje, përkufizimet që përdoren këtu kanë kuptimet në vijim:

Inspektor – nënkupton një nëpunës të AAC-së, të cilit i është akorduar ky titull pas plotësimit të disa kushteve të nevojshme të cilat janë përcaktuar në manualin përkatës dhe në përputhje me procedurat e përshkruara në manualin e cilësisë, të cilit i jepet e drejta të kryejë detyra të veçanta mbikëqyrjeje të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil;

Kredenciale – nënkupton:

- a) Llojin e kualifikimit të veçantë në lidhje me kompetencat e AAC-së, i cili i jep bartësit të saj disa të drejta të caktuara dhe obligime në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, këtë Rregullore; dhe/apo
- b) Një kartelë plastike e lehtë dhe e hollë e printuar mirë, me informata personale të inspektorit të AAC-së, të caktuara në këtë Rregullore dhe shtojcën e saj.

Trajnim në punë (TNP) - nënkupton fitimin e njohurive, shkathtësive, dhe kompetencave si rezultat i mësimit të shkathtësive profesionale dhe praktike dhe njohurive që lidhen me kompetenca të veçanta mbikëqyrëse;

LAC - nënkupton Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008);

AAC - nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovë, i themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

Komisioni i ankesave - nënkupton komisionin e AAC-së të themeluar me Vendimin Nr. 03/ZDP/VE/2011, datë 16 gusht 2011.

Neni 3

Identifikimi i inspektorëve të AAC-së

3.1 Kartela e kredencialeve të inspektorit do të identifikojë bartësin e saj si një përfaqësues të akredituar të AAC-së, të autorizuar për të ushtruar funksione e detyra të veçanta mbikëqyrëse, në kuadër të përgjegjësisë të dhëna në LAC dhe në këtë Rregullore.

3.2 Inspektorët e AAC-së duhet ta ekspozojnë kartelën e kredencialeve dhe të prezantohen para se të ndërmarrin çfarëdo detyre të përshkruar në nenin 4.

Neni 4

Autorizimet e inspektorëve të AAC-së

Inspektorët e AAC-së janë të autorizuar, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë të kornizës ligjore të përshkruara më lartë në nenin 3.1, të:

- a) kërkojnë dhe t'u lejohet qasje e papenguar në secilin mjet ajror, strukturë të mjetit ajror, pajisjet dhe veglat të tij, si dhe dokumentet, duke përfshirë certifikatat dhe manualët e secilit anëtar të audituar apo të inspektuar të ekuipazhit të fluturimit të një operatori të huaj apo vendor;

- b) kryejë inspektime gjatë fluturimit dhe kontrole të linjave, kryejnë inspektime gjatë fluturimit të një mjeti ajror të ri dhe linjave të reja, të filluara në operimet e një operatori;
- c) kërkojnë dhe t'u lejohet qasje e papenguar te Ofruesit e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (OSHNA), strukturat e tyre, pajisjet e veglat, si dhe dokumentet, duke përfshirë certifikatat, manualët, regjistrat dhe të dhënat e çdo zyrtari të OSHNA-s;
- d) kërkojnë dhe t'u lejohet qasje e papenguar në aerodrome, strukturat e tyre, pajisjet e veglat, si dhe dokumentet, duke përfshirë certifikatat, manualët, regjistrat dhe të dhënat e çdo zyrtari të aerodromit;
- e) mbikëqyrin dhe vëzhgojnë implementimin e dispozitave përkatëse të LAC-it dhe/apo akteve nënligjore që burojnë prej tij, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (këtu e tutje "Drejtori i përgjithshëm");
- f) marrin dëshmi dhe të lëshojnë urdhra për secilin person të paraqitet në AAC dhe të ofrojnë dokumente dhe dëshmi në lidhje me çfarëdo çështje e cila është objekt hetimi;
- g) marrin në pyetje të gjithë personat, prezenca e të cilëve vlerësohet si e nevojshme për zhvillimin e një hetimi dhe/apo procedure administrative;
- h) kontrollojnë dokumentet e identifikimit të secilit person i cili i nënshtrohet inspektimit, auditimit apo hetimit;
- i) Përpilojnë raporte për auditime/inspektime të cilat zhvillohen sipas pikave (a), (b), (c), (d), (e), (f) dhe (g) të këtij neni;
- j) Kërkojnë asistencën e zyrtarëve/autoriteteve tjera publike dhe strukturave të policisë, nëse ndeshen me ndonjë sulm apo refuzim për t'i trajtuar me respekt, apo nëse një ballafaqim i tillë është i pritshëm në mënyrë të arsyeshme nga ndonjë person gjatë kryerjes së autorizimeve të dhëna nën pikat (a),(b),(c),(d),(e),(f),(g) dhe (h) të këtij neni.

Neni 5

Autoriteti aprovues

Drejtori i përgjithshëm është autoriteti aprovues për dhënien e kredencialeve. Departamenti i Administratës do të administrojë procesin e lëshimit dhe kontrollit të kredencialeve të lëshuara.

Neni 6

Dukja e kartelës së kredencialeve të inspektorit

6.1 Kredencialet e shtypura në kartelë të hollë e të lehtë nga plastika, që përdoret për identifikimin dhe autorizimet e inspektorit të AAC-së gjatë ushtrimit të detyrave të mbikëqyrjes, është kartelë me dy anë me dimensione 85mm x 55mm, me stemën e Republikës së Kosovës dhe emblemën e AAC-së, fotografinë e bartësit me dimensione 33mm x 27mm, numrin serik, datën e lëshimit dhe atë të skadimit, titullin dhe emrin e bartësit në anën e përparme dhe e cila përmban këtë deklaratë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, në anën e pasme:

"Me këtë vërtetohet se bartësi i këtyre kredencialeve është inspektor i autorizuar i AAC-së për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në përputhje me nenin 15.1 (h) të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe akteve tjera nënligjore në fuqi. Ai/Ajo mundet pa ndonjë autorizim apo kufizim të posaçëm, të hyjë dhe inspektojë çdo mjet civil ajror apo objekt(pajisje) të aviacionit civil në Kosovë dhe të inspektojë personelin e aviacionit. Bartësi i këtyre kredencialeve ka të drejtë të ndalojë operimin e mjetit ajror, objektit (pajisjes) apo personelit të inspektuar të aviacionit".

6.2 Forma e kredencialeve është dhënë në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Përdorimi i kredencialeve

7.1 Kredencialet do të përdoren vetëm për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësiwe zyrtare, të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, LAC dhe/apo aktet normative që burojnë prej tij, të lëshuara nga AAC-ja. Bartësi i kredencialeve është përgjegjës për ruajtjen e kredencialeve. Keqpërdorimi apo posedimi i pavend i kredencialeve mund t'u nënshtrohet masave disiplinore kundër shkelësit.

7.2 Inspektorët e AAC-së, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre të caktuara, dhe gjatë ndërveprimit me operatorë, personelin e operatorëve dhe publikun në përgjithësi, duhet të mbajnë gjykim të mirë dhe sjellje profesionale të cilat reflektojnë politikat e praktikat e AAC-së, dhe gjithashtu duhet të përmbahen nga ndonjë veprim i pavend i cili do të dëmtonte kredibilitetin e AAC-së si institucion publik i autorizuar me ligj për të kryer detyra dhe përgjegjësi rregullatore në fushën e aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Neni 8

Raportimi i keqpërdorimit të autorizimit

Secili person që vlerëson se i është nënshtruar një trajtimi të papërshtatshëm nga një inspektor i AAC-së, apo i cili pretendon se ka pasur keqpërdorim të autorizimeve të inspektorit, duhet ta dorëzojë ankesën e tij/saj me shkrim duke ia adresuar atë komisionit të ankesave të AAC-së në një zarf të mbyllur, brenda 15 ditëve pas ditës

në të cilën ka ndodhur situata e pretenduar.

Neni 9
Dispozitat kalimtare

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje dhe deri më 10 tetor 2011, të gjithë inspektorët që bartin kartela të kredencialeve duhet t'i kthejnë ato dhe atyre do t'u lëshohen të rejat në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 25 shtator 2011.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm

Shtojca 1

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo	 CAA Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo
Foto	Emri / Ime / Name: EMRI MBIEMRI
	Data e lëshimit / Datum Izdavanja / Issuing Date: dd.mm.vvvv
	Data e skadimit / Datum Isteka / Expiry Date: dd.mm.vvvv
Serial No: CAA-XX/XXXX	FLIGHT OPERATIONS

"Me këtë vërtetohet se bartësi i kësaj kartele është inspektor i autorizuar i AAC-së për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në përputhje me nenin 15.1 (h) të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe akteve nënligjore në fuqi. Ai/Ajo mundet pa ndonjë autorizim apo kufizim të posaçëm, të hyjë dhe inspektojë çdo mjet civil ajror apo objekt(pajisje) të aviacionit civil në Kosovë dhe të inspektojë personelin e aviacionit. Bartësi i kësaj kartele ka të drejtë të ndalojë operimin e mjetit ajror, objektit (pajisjes) apo personelit të inspektuar të aviacionit".

"Ovime se potvrđuje da je nosilac ove kartice ovlašćeni inspektor ACV-a za poduzimanje svih mera u skladu sa Članom 15.1 (h), Zakona br. 03/L-051 o Civilnom Vazduhoplovstvu podzakonskih akata na snazi. On/ona može bez posebnog ovlašćenja ili ograničenja ući i izvršiti inspekciju bilo kojeg civilnog vazduhoplova ili vazduhoplovnog objekta u Kosovu i izvršiti inspekciju vazduhoplovnog osoblja. Nosilac ove kartice ima pravo da zabrani daljnje delovanje inspektovanog vazduhoplova, objekta ili vazduhoplovnog osoblja".

"This is to certify that the holder of these Credentials is a duly authorized inspector of CAA for undertaking all actions in accordance with Article 15.1 (h) of Law No. 03/L-051 on Civil Aviation and other secondary legislation in force. He/she can enter and inspect any civilian aircraft or aviation facility in Kosovo and inspect aviation personnel, without any special authorization or restrictions. Holder of these Credentials has the power to deny inspected aircraft, facility or aviation personnel from operation".